REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr._____prot Datë, ___/___/2026

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI (MZSH).

Në zbatim të Ligjit Nr. 152, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; VKM Nr.520, datë 25.07.2019, "Për Miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Kreu III "Ndarja E Funksioneve, Nivelet, Detyrat, Procedurat E Përzgjedhjes për emërim, lirim, pezullim dhe përjashtim", Bashkia Lushnje hap shpalljen e proçedurës për pozicionet e lirë:

LUFTUES/SHPËTUES/PUNONJËS TË NIVELIT BAZË (1 POZICION)

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës:

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Luftues/Shpëtues/Punonjës të shërbimit bazë është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut. Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

KUSHTET DHE KRITERET ;

- Kandidatët për pozicionet" Luftues/Shpëtues/Punonjës të nivelit bazë " duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
4. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
5. Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
6. Të mos jetë i/e dënuar me vendim të forcës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
7. Të jetë i moshës nën 30(tridhjetë)vjeç;
8. Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Aplikanti duhet të paraqes në njësinë e burimeve njerëzore dokumentacionin si me poshtë:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit;
2. Formular aplikimi i për pranim në shërbimin e MZSH;(formular cili tërhiqet pranë Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi)
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Një kopje të jetë shkrimit (CV);
5. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit të lartë;
6. Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe fotokopje e dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "C"
7. Çertifikatë e gjendjes gjyqësore;
8. Çertifikatë familjare;
9. Vërtetim nga gjykata;
10. Vërtetim nga prokuroria;
11. Raport mjeko-ligjor, që vërteton "gjëndje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar"
12. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
13. Fotografi (2.5x3.5 cm) 2 copë;

Dokumentat duhet të dorëzohen pranë zyrës së Protokollkit në Bashkinë Lushnje, brenda datës: 22.05.2026.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE